



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2022

VENDIM

Nr. 219, datë 16.06.2022

**PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

V E N D O S I :

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, Arbana Selmanaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...}, {...} etj.; Akuza: Nenet 283/a/-22 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Besmir Stroka, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Nenet 298/3, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUIJË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Artan Çupi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria Krujë ndaj {...}; Objekti: Dërgim në gjyq; Akuza: Neni 283/2 i Kodit Penal.
2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Murat Lleshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...} etj.; Akuza: Neni 283/2 i Kodit Penal.
3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Artan Çupi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 235 i Kodit Penal.
4. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Artan Çupi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...} etj.; Akuza: Neni 120 i Kodit Penal.
5. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Murat Lleshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 284/1 i Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Luljeta Kole, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen civile me Paditës: {...}, {...}; Të paditur: {...}; Objekti: Pjestim i sendit të përbashkët.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR LEZHË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Aurel Arapi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 139-25 i Kodit Penal.
2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Alda Sadiku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: Nenet 130/a1 dhe 277 të Kodit Penal.
3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Alda Sadiku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin {...}; Akuza: Vepër penale parashikuar në nenet 78/a, 278/1 të Kodit Penal.
4. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Aurel Arapi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...} dhe {...}; Akuza: Neni 283/2 i Kodit Penal.

5. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Alda Sadiku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Nenet 79/dh-25, 279/1/2/3/4 të Kodit Penal.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Arta Llazari, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Person i tretë: {...}; Objekti: Heqje e zotësisë juridike për të vepruar për shtetasen {...} dhe caktimin si kujdestar të bashkëshortit të saj shtetasin {...}.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR FIER

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Ersida Bajgora, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 109/b/1 dhe 99 të Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Miranda Nakaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Neni 79/c dhe 50 'e/1', 278/7/2 dhe 274 të Kodit Penal.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Miranda Nakaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}; Akuza: Neni 180/3, 181, 143/3, 287 të Kodit Penal.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË GJIROKASTËR

1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Ligoraq Toshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, çështjen civile me Paditës: {...}; I paditur: {...}, {...}, {...}; Person i Tretë: {...}; Objekti: Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Aktit AMTP në emër të {...} Detyrimin e Zyrës së Regjistrimit ASHK Tepelenë, të regjistrojë edhe 1000 (njëmijë)m2 truall arë në emër të {...}.

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Lutfije Celami, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: Nenet 283/a/1-22, 28/4,333/a/1 dhe 334/1 të Kodit Penal.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, Lutfije Celami dhe Ilir Toska, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...} dhe {...}; Akuza: Nenet 283/a/1 e 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Genti Dokollari dhe Laurent Fuçia, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me Paditës: {...} , etj.; Të paditur: {...}; Objekti: “Shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror, etj.”

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, Iliba Bezati dhe Genti Dokollari, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, çështjen civile me Paditës: {...}, etj; Të paditur: {...}, {...}, {...} etj; Objekti: Njohjen e të drejtës së pronësisë, etj.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ZËVENDËSKRYETARI

ILIR RUSI